



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Financave*  
*Ministarstvo za Finansije*  
*Ministry of Finance*



*Dogana e Kosovës – Carina Kosova*  
*Kosovo Customs*

# Plani Strategjik

## 2013 -2015







**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave*  
*Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance*



*Dogana e Kosovës – Carina Kosova – Kosovo Customs*

# Plani Strategjik

2013 - 2015

Përpiluar nga:

**Bujar Shatri**

Drejtor për planifikim strategjik

Drejtoria e Doganës, Prishtinë- Republika e Kosovës.

Tel: 038 540 796

Fax: 038 540 065

E-mail: [hq@dogana-ks.org](mailto:hq@dogana-ks.org)

Plani strategjik 2013-2015 është gjithashtu në dispozicion nëpërmjet faqes së internetit të Doganës:

**[www.dogana-ks.org](http://www.dogana-ks.org)**

Prill ,2013



## Përmbajtja

PARATHËNIE		6
PLANIFIKIMI STRATEGJIK		8
VIZIONI		9
DEKLARATA E MISIONIT		9
VLERAT DHE PARIMET E DOGANËS		11
SFIDAT DHE RREZIQET		12
QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE		12
QËLLIMI STRATEGJIK 1		13
QËLLIMI STRATEGJIK 2		17
QËLLIMI STRATEGJIK 3		20
QËLLIMI STRATEGJIK 4		23
QËLLIMI STRATEGJIK 5		24
MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS		27

---

## Parathënie

Administrata Doganore e Kosovës është autoriteti i vetëm në kuadër të Ministrisë së Financave që është përgjegjës për zbatimin e politikave doganore në Republikën e Kosovës.

Ky Plan Strategjik do të përfshijë periudhën prej tri viteve - nga Janari 2013 deri në Dhjetor 2015 dhe do të përcaktojë pritjet e Qeverisë, komunitetit të biznesit dhe opinionit të gjerë nga standardet e performancës menaxheriale dhe arritjeve operative. Strategjia përcakton qartë se ku pritet të jetë Administrata Doganore në fund të periudhës, sa i përket standardit të shërbimeve për komunitetin e biznesit dhe publikun e gjerë, performancës operacionale, infrastrukturës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Administrata Doganore e Kosovës luan një rol të rëndësishëm në stabilitetin e përgjithshëm të ekonomisë së Kosovës duke menaxhuar dhe mbledhur një përqindje domethënëse të të hyrave publike. Prandaj, realizimi i Planit Strategjik do të vazhdojë të mbështesë dhe përmirësojë rolin e saj, gjithashtu, duke luajtur një rol të madh në sigurimin e zhvillimit të mëtejshëm të Administratës Doganore në procesin drejtë integrimi evropian.

Administrata Doganore gjatë viteve të fundit ka bërë një progres të dukshëm dhe ka marrë hapa pozitiv në proceset e modernizimit dhe zhvillimeve, duke pasur për qëllim harmonizimin e procedurave administrative dhe sistemeve me ato të BE-së. Sukseset që shquhen përfshijnë: Strukturën e Zbatimit të Ligjit; Sektorin e TI-së, Origjinës, Vlerës, Auditimit të Brendshëm, Kontrollit të Brendshëm (Etika), Auditimit të Jashtëm dhe Kontrollit pas Zhdoganimit, të Drejtën e Pronësisë Intelektuale (DPI), si dhe Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK).

Këto përpjekje janë ndërmarrë individualisht nga Dogana e Kosovës dhe në partneritet me EULEX-in e, po ashtu, edhe me projektet e tjera të përkohshme të BE-së dhe donatorëve të tjerë mbi asistencën teknike. Administrata Doganore do të vazhdojë me përpjekjet për të ofruar një shërbim të shkëlqyer në të gjitha sferat e përgjegjësisë, por, e pranon që ka ende vend për zhvillime dhe përmirësime të mëtejme.

Administrata Doganore e Kosovës përballlet me shumë sfida operacionale, të cilat përfshijnë shtimin e qarkullimit të njerëzve, mallrave, parave dhe informacioneve, dhe në këtë mënyrë një ndër prioritetet kryesore të Doganës së Kosovës është që të ketë në shënjestër ata që përfaqësojnë rrezikun më të madh ndaj vendit tonë. Edhe pse këta faktorë mund të ofrojnë, po ashtu, shumë perspektiva për promovimin e

biznesit ndërkombëtar dhe rritjen e ekonomisë së Kosovës, e që fatkeqësisht, mundësi të tilla ngrisin, po ashtu, aktivitetin potencial të krimeve. Si pasojë, Administrata Doganore duhet të jetë fleksibile dhe kurdoherë në gjendje që të adaptohet, të kontrollojë dhe të menaxhojë këto rreziqe në kufijtë dhe në territorin tonë.

Si një nga Agjencitë Kufitare kryesore të Kosovës, Dogana është përgjegjëse për parandalimin e kontrabandës me mallra, narkotikë, armë, armë të shkatërrimit në masë (ASHM), mallra që shkelin të Drejtën e Pronësisë Intellektuale dhe mallrat e tjera ilegale dhe/ose të ndaluara; mbrojtjen e shoqërisë, shëndetin e qytetarëve, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore, duke mbledhur detyrime fiskale dhe taksa, duke përmirësuar lehtësimet tregtare dhe duke ndihmuar në tërheqjen e investimeve nga jashtë, duke luftuar kundër krimit të organizuar dhe atij ndërkufitar dhe duke garantuar siguri përgjatë territorit doganor, e po ashtu edhe opinionit të gjerë publik. Veç kësaj, Administrata Doganore zbaton rregulla të kontrollit në eksport dhe ofron mbështetje dhe ndihmë në lehtësimin e tregtisë legjitime duke i ofruar Qeverisë statistika të sakta tregtare.

Në lidhje me Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK), kjo Administratë është në krye të promovimit të parimeve kryesore të udhërrëfyesve të BE-së mbi MIK-it për implementimin e lehtësirave efektive dhe efikase në qarkullimin legjitim të njerëzve, veturave dhe mallrave, duke i siguruar kufijtë dhe duke i përmbushur kërkesat ligjore kombëtare. Për më tepër, kjo Administratë Doganore është e fokusuar në ofrimin e një shërbimi doganor të përmirësuar dhe krijimin e një organizate e cila vepron në mënyrë të drejtë, të hapur dhe në partneritet me bizneset lokale, komunitetin tregtar në përgjithësi dhe, po ashtu, edhe me publikun e gjerë. Me këtë Plan Strategjik, Administrata Doganore do të fokusohet në zhvillimin e këtyre sferave të rëndësishme të punës dhe do të vazhdojë, po ashtu, në ndërtimin e progresit i cili është arritur deri më sot.

Ky Plan Strategjik përcakton Misionin e Administratës Doganore të Kosovës dhe objektivat strategjike për periudhën 2013-2015.

Naim Huruglica  
Drejtor i përgjithshëm

## Planifikimi strategjik

Plani Strategjik i Doganës së Kosovës është një nga mjetet më të rëndësishme që përdoret për të definuar prioritetet dhe veprimet e Doganës për vitet fiskale 2013-2015.

Ky plan është dizajnuar për të orientuar përpjekjet për planifikim strategjik të drejtorive, departamenteve, sektorëve dhe njësive të ndryshme brenda Doganës së Kosovës. Plani strategjik 2013-2015 do të mundësojë zhvillimin e strategjive efektive përmes vendosjes së prioriteteve kyçe të nevojshme për të arritur misionin e Doganës dhe për të përmirësuar performancën organizative.

Implementimi i Planit Strategjik do të bëhet përmes veprimeve dhe aktiviteteve konkrete, në përputhje me prioritet e Qeverisë, të parapara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), të miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Ky plan është themeli i një kornize të përgjithshme që ndërlidh planifikimin strategjik të Doganës me procesin e shpërndarjes së burimeve financiare dhe njerëzore. Korniza e Menaxhimit Strategjik do të jetë një proces që do të përdoret për të siguruar zbatimin e planit dhe realizimin me sukses të qëllimeve dhe objektivave strategjike të Doganës së Kosovës.

Dogana e Kosovës është Agjenci me pavarësi operationale në kuadër të Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës. Planifikimi Strategjik i Doganës së Kosovës mbështet në dokumentet strategjike dhe politikat zhvillimore të Ministrisë së Financave dhe të Qeverisë së Kosovës, si dhe në standardet dhe praktikat më të mira që aplikohen nga administratat moderne doganore.

Plani strategjik 2013-2015 adreson edhe rekomandimet e standardeve të kërkuara të udhërrëfyesit të BE për doganat - EU BluePrint, Konventave dhe deklaratave për funksionimin e administratave doganore, ligjeve dhe direktivave nga DG TAXUD, si dhe dokumenteve të dala që përkrahin zhvillimin dhe modernizimin e administratave doganore.

Ky Plan Strategjik mbulon periudhën trevjeçare 2013-2015 dhe është i hartuar në harmoni me dokumentet strategjike të mëposhtme:

- Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016 të Ministrisë së Financave
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2013-2015 dhe Kornizën Buxhetore 2013-2015;
- Plani për zbatimin e Vizionit të Zhvillimit Ekonomik 2011-2014 për periudhën dhe fushat që i mbulon;
- Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim për periudhën që mbulon;
- Strategjitë Nacionale nga fusha e zbatimit të ligjit;
- Udhërrëfyesit doganor të BE-së – EU Blueprint

## Vizioni

Gjatë 3 viteve të ardhshme, ne do të transformojmë edhe më tej qasjen tonë për kontrollin doganor të kufijve dhe zbatimin e ligjit, duke operuar si një agjenci plotësisht e integruar dhe e orientuar në rezultate, e drejtuar nga intelijenca, dhe në bashkëpunim të plotë me partnerët tanë.

Oficerët tanë do të jenë në gjendje për të rritur vëmendjen e tyre në mbrojtjen efikase të kufijve shtetërorë dhe ekonomisë së vendit tonë, duke bërë planifikimin e operimeve dhe shpërndarjen e burimeve, bazuar gjithnjë në informacionin paraprak dhe në inteligjencë, si dhe duke shfrytëzuar infrastrukturën dhe teknologjinë moderne për të realizuar misionin tonë.

Punonjësit tanë do të kryejnë detyrat e tyre me përsosmëri, duke përdorur qasjen e bazuar në analizën e rrezikut dhe në teknikat e kontroleve selektive të mallrave dhe udhëtareve, për të maksimizuar rezultatet dhe potencialin e Doganës së Kosovës. Më e rëndësishmja - Dogana e Kosovës do të përfaqësojë standardet më të larta të integritetit në zbatimin e ligjit me personel të trajnuar dhe të aftë për të përmbushur objektivat e saj gjatë 3 viteve të ardhshme, dhe më tej.

## Deklarata e Misionit

Në kryerjen e detyrave që lidhen me kontrollin doganor të kufirit dhe mbledhjen e të hyrave buxhetore, Dogana e Kosovës është përgjegjëse edhe për mbrojtjen e shoqërisë dhe promovimin e tregtisë ndërkombëtare.

Për këtë qëllim, ne bashkëpunojmë edhe me autoritetet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, veçanërisht me ato që janë përgjegjëse për zbulimin dhe ndjekjen e aktiviteteve të paligjshme kriminale, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ne angazhohemi që të:

- Mbrojmë interesat financiare të Kosovës, duke siguruar të hyra të konsiderueshme të ardhurave buxhetore;
- Mbrojmë interesat financiare të Kosovës, duke luftuar tregtinë e padrejtë dhe të paligjshme, duke mbështetur aktivitetet ligjore ekonomike dhe duke lehtësuar tregtinë ndërkombëtare;
- Mbrojmë interesat e Kosovës dhe sigurinë e qytetarëve të saj, duke parandaluar importin e mallrave të paligjshme dhe të ndaluara, gjithnjë duke zbatuar ligjet dhe rregulloret në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Kontribuojmë në forcimin e aftësisë konkurruese të ekonomisë kosovare, duke aplikuar metodat moderne të punës, të mbështetur nga sisteme të avancuara informative dhe me qasje të lehtë nga operatorët ekonomikë.

Në zbatimin e këtyre aktiviteteve, do të jemi aktiv në parandalimin e evazionit fiskal dhe mashtrimeve financiare , duke luftuar në mënyre efikase krimin e organizuar dhe organizatat kriminale që paraqesin rrezik për shoqërinë dhe për vendin në përgjithësi.

**Misioni i Administratës Doganore është i përcaktuar sipas deklaratës vijuese.**

#### DEKLARATA E MISIONIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE

*Misioni i Administratës Doganore të Kosovës është që të ofrojë zhdoganim dhe kontroll të shpejtë të tregtisë legjitime dhe udhëtarëve, mbrojtje dhe sigurim të territorit doganor, përmes mbledhjes efektive dhe efikase të të hyrave në pajtim me rregulloret, gjithnjë duke pasur për qëllim zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.*

Administrata Doganore e Kosovës do të vazhdojë të sigurojë që puna dhe shërbimet e ofruara do të jenë në përputhje të plotë me standardet e BE-së, Organizatës Botërore të Tregtisë dhe Organizatës Botërore të Doganave. Në mënyrë që të arrihet sukses në standardet e tilla, Dogana e Kosovës do të përdorë udhëzimet për praktikën më të mirë, të përcaktuara në Udhërrëfyesin Doganor të BE-së për doganat, si një qendër e planifikimit tonë operacional.

Mbledhja efikase e të hyrave nga Administrata Doganore e Kosovës është vendimtare për shoqërinë kosovare, pasi që taksat dhe detyrimet e mbledhura ndihmojnë në pagesën e shërbimeve mjekësore, shërbimeve arsimore, shërbimeve publike dhe, po ashtu, financojnë zhvillimet e ardhshme të vendit.

Një faktor tjetër për të ardhmen e Kosovës në rritjen e ekonomisë është - rritja e tregtisë me vendet e tjera. Është e rëndësishme që Dogana e Kosovës të lehtësojë tregtinë dhe transportin e udhëtarëve, në atë mënyrë që t'i inkurajojë bizneset nga jashtë, të krijojnë raporte tregtare dhe që ata të investojnë në Kosovë.

Ne, po ashtu, duhet të balancojmë këto kërkesa për lehtësimet në qarkullimin e mallrave dhe udhëtarëve, me përgjegjësinë për të mbrojtur territorin doganor dhe kufijtë e Kosovës. Administrata Doganore e Kosovës është përgjegjëse për mbrojtjen e kufijve nga kërcënimet ndaj qëndrueshmërisë fiskale, si dhe sigurisë së Kosovës. Administrata Doganore e Kosovës do të vazhdojë të ndalojë rreziqet fiskale që kontrabanda me mallra i shkakton shoqërisë sonë. Dogana e Kosovës do të luftojë kundër rreziqeve shoqërore dhe fizike ndaj shoqërisë sonë, duke zbuluar, konfiskuar dhe parandaluar kontrabandën me mallra të ndaluara, siç janë drogat e

palicencuara, armët, mallrat e falsifikuara dhe materialet e organizmat e tjerë të dëmshme.

Mbrojtja e kufijve të Kosovës nuk fillon dhe mbaron me praninë e stafit doganor nëpër pikë- kalimet kufitare dhe aeroport. Kërcënimet me të cilat përballlet vendi ynë dhe qytetarët tanë në kufij, në mënyrë të vazhdueshme, janë duke u rritur, prandaj Dogana e Kosovës duhet të jetë në gjendje të reagojë shpejtë ndaj rreziqeve potenciale që shfaqen. Në mënyrë që të arrihet kjo, Administrata Doganore e Kosovës duhet të vazhdojë të investojë në shfrytëzimin adekuat të vlerësimit të rrezikut dhe inteligjencës. Dogana e Kosovës, po ashtu, do të merret dhe do të luftojë me vendosmëri të gjithë ata të cilët duan t'i shmangen ligjit dhe duke e vënë në rrezik sigurinë e Kosovës.

Synimet tona kryesore nuk mund të arrihen pa strukturë të fuqishme dhe efikase të menaxhimit. Kjo strukturë përfshinë sisteme efektive financiare, rekrutim cilësor, fuqi punëtore të aftësuar dhe të motivuar, qarkullim të përmirësuar të informatave dhe futje në përdorim të teknologjisë moderne. Prandaj, Administrata Doganore e Kosovës është e përkushtuar të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e funksioneve të veta të përbashkëta brenda periudhës së kësaj strategjie.

## Vlerat dhe parimet e Doganës

Dogana e Kosovës është një Agjenci e pavarur dhe e përkushtuar që t'i ofrojë shërbim të përsosur tatimpaguesve dhe publikut. Në realizimin e misionit të vet - Dogana e Kosovës do të bazohet në këto vlera dhe parime themelore:

- besim dhe respekt të ndërsjellë;
- barazi dhe drejtësi;
- integritet dhe ndershmëri;
- transparencë dhe sinqeritet;
- efikasitet dhe përkushtim;
- partneritet me institucionet e tjera;
- partneritet me komunitetin e biznesit;
- eliminim të çdo lloj konflikti të interesit;

## Sfidat dhe rreziqet

- Rritja e vazhdueshme e fluksit të udhëtarëve dhe mallrave tregtare;
- Arritja e baraspeshës së duhur në mes të kontrollit doganor dhe lehtësirave tregtare;
- Kërkesat në rritje për kontrollin doganor kufitar dhe në brendësi;
- Zbatimi i drejtë i Legjislacionit kompleks doganor, dhe atij mbi akcizat;
- Zbatimi i drejtë i konventave ndërkombëtare;
- Ndryshimet e vazhdueshme dhe praktikrat e reja në tregtinë ndërkombëtare;
- Kërcënimet eventuale ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Niveli i lartë i evazionit fiskal, sidomos në kufirin verior të Kosovës;
- Komplexiteti dhe shumëllojshmëria e veprave penale doganore;
- Përmirësimi i imazhit publik të Doganës;
- Ndryshimet e shpejta teknologjike;

## Qëllimet dhe Objektivat Strategjike

Qëllimet dhe Objektivat Strategjike të Doganës së Kosovës janë në përputhshmëri të plotë me strategjinë dhe politikat zhvillimore të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë së Kosovës, për krijimin e një administrate moderne doganore, avancimin e një sistemi efikas të vjeljes së të hyrave, lehtësimin e tregtisë legjitime dhe fuqizimin e kapaciteteve për mbrojtjen e shoqërisë.

Në përputhje me vizionin dhe misionin tonë strategjik, ne kemi identifikuar dhe parashtruar **5 qëllime strategjike**, të cilat më së miri reflektojnë përgjegjësitë tona ndaj ekonomisë dhe shoqërisë kosovare, të cilat do të na mundësojnë t'i kontribuojmë rritjes dhe zhvillimit të suksesshëm të ekonomisë dhe integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

**Dogana e Kosovës planifikon të realizojë misionin e saj përmes arritjes së qëllimeve kryesore strategjike si më poshtë:**

Qëllimi strategjik	1	Krijimi i një sistemi modern dhe efikas për mbledhjen e të hyrave dhe ofrimin e lehtësirave tregtare;
Qëllimi strategjik	2	Mbrojtja e qytetarëve të Kosovës nga importi i mallrave të ndaluara, dhe lufta efikase kundër krimit të organizuar dhe kontrabandës,
Qëllimi strategjik	3	Modernizimi i Doganës së Kosovës sipas standardeve të Udhërrëfyesit Doganor të BE (EU Blueprint),
Qëllimi strategjik	4	Rritja e transparencës, përmirësimi i imazhit dhe edukimi i publikut për rolin dhe misionin e Doganës,
Qëllimi strategjik	5	Përmirësimi i etikës doganore dhe parandalimi i korrupsionit dhe çdo lloj konflikti të interesit.

Këto qëllime strategjike do të arrihen përmes realizimit të objektivave dhe ndërmarrjes së masave të nevojshme në të gjitha nivelet e Doganës së Kosovës. Ky Plan Strategjik shpjegon se si, brenda tri viteve të ardhshme - Administrata Doganore planifikon të arrijë këto rezultate dhe t'i përmbushë Qëllimet e Strategjisë.

**Qëllimi strategjik 1:**

***Krijimi i një sistemi modern dhe efikas për mbledhjen e të hyrave dhe ofrimin e lehtësirave tregtare***

Shumica e bizneseve importuese, duke përfshirë edhe obliguesit ndaj akcizës së brendshme, dëshirojnë në mënyrë vullnetare të përmbushin detyrimet e tyre, duke paguar vlerën reale të taksave për çka obligohen. Dogana e Kosovës është e përkushtuar t'i ndihmojë dhe mbështesë tatimpaguesit kosovarë që t'i përmbushin obligimet e tyre ligjore, në mënyrë sa më të lehtë dhe efikase. Në anën tjetër - ajo do të ashpërsojë edhe më shumë masat ndaj atyre që shkelin ligjet dhe tentojnë t'iu shmangen obligimeve të tyre. Objektivat tona janë që, gjate këtyre tri viteve, të krijojmë një sistem efikas dhe të thjeshtë për mbledhjen e të hyrave nga dogana, TVSH dhe akciza, sikundër - të zvogëlojmë ndjeshëm nivelin e evazionit fiskal dhe të mos përmbushjes.

Ne do të përmirësojmë dukshëm kualitetin dhe qartësinë e këshillave dhe sqarimeve ligjore që japim përmes telefonit, komunikimit elektronik dhe atyre që realizohen përmes takimeve të drejtpërdrejta me palë. Një ndër zotimet dhe qëllimet tona kryesore, do të jetë përmirësimi, gjegjësisht rritja e numrit të këshillave

për taksapaguesit përmes komunikimit elektronik. Do të vazhdojmë të japim këshilla për kompanitë që janë të interesuara të shfrytëzojnë procedurat me ndikim ekonomik, përfshirë prodhuesit vendorë të mallrave me akcizë dhe kompanive që prodhojnë për eksport.

Në të njëjtën kohë, do të zhvillojmë edhe më tutje kapacitetet njerëzore, duke përmirësuar ekspertizën e tyre, sidomos në fushat që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në të hyrat e mbledhura, siç janë klasifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi i mallrave. Kjo do të arrihet me edukimin e vazhdueshëm të stafit në këto fusha specifike, duke shfrytëzuar edhe asistencën teknike të Komisionit Evropian, por edhe të donatorëve të tjerë.

Duke shfrytëzuar metoda më të avancuara në identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve tek bizneset e mëdha, ne do të fokusojmë resurset tona më të mira në çështjet ku janë rreziqet më të larta për shmangien e taksave. Ne do vazhdojmë të këshillojmë dhe do të punojmë bashkë me importuesit e mëdhenj, me qëllim të sigurimit - se ata kanë të vendosur një sistem të drejtë të evidencës dhe deklarimit të drejtë të obligimeve doganore dhe tatimore.

Me qëllim të zvogëlimit të kostos për tregtinë ndërkombëtare, synojmë arritjen e baraspeshës adekuate ndërmjet kontrollit doganor dhe krijimit të lehtësirave tregtare, duke shfrytëzuar teknikat për vlerësimin e rrezikut dhe kontrollet selektive, bazuar në profilizimin paraprak. Në këtë mënyrë do të vazhdojmë të ulim edhe më tej nivelin e kontrolleve fizike dhe dokumentare me rastin e importit, me qëllim zvogëlimin e kohës së nevojshme për përfundimin e procedurave doganore. Duke vazhduar përmirësimin e metodave për vlerësimin e nivelit të riskut dhe arritjen e caqeve të vlerësuara për përmbushje, ne do të sigurojmë se të gjithë ata që synojnë të shmangin pagesën e taksave, do të jenë subjekt i masave tona të fuqishme administrative dhe kriminale ndaj tyre. Kjo do të rrisë efektivitetin në punën tonë dhe do ta bëjë më të vështirë shmangien e pagesës së taksave. Sistemi aktual i dënimeve, mundëson një ndëshkim të drejtë, konform nivelit të vlerësuar të shmangieve.

Ne do të vazhdojmë të luftojmë ekonominë joformale, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet e tjera qeveritare, posaçërisht ato të zbatimit të ligjit. Me Policinë e Kosovës do të vazhdojmë bashkëpunimin në luftimin e kontrabandës së mallrave përmes kufijve, kurse me Administratën Tatimore të Kosovës do të punojmë ngushtë në identifikimin e atyre bizneseve, që nuk deklarojnë drejte obligimet e tyre tatimore, me rastin e importit të mallrave dhe pagesën e akcizës së brendshme,

përfshire akcizën në lojërat e fatit. Në sistemin e ri ASYCUDA, do të zhvillojmë edhe një modul të ri për kontrollin dhe mbikëqyrjen e lëvizjes së mallrave brenda vendit, e që i nënshtrohen pagesës së akcizës.

Ne do të vazhdojmë të zhvillojmë kapacitetet tona të inteligjencës, në drejtim të përmirësimit në parandalimin dhe zbulimin e shmangies së taksave. Në rastet kur ndodhin shmangiet e taksave, do të përmirësojmë kapacitetet tona për zbulim sa me të hershëm të mundshëm dhe trajtim të shpejtë, duke përdorur drejt dhe në mënyre efektive ndryshimet legjislative që na japin mundësi për hetime efektive penale. Do të rrisim bashkëpunimin me Prokurorinë e Shtetit, me qëllim të kryerjes së hetimeve të plota kriminale dhe goditjen efektive të grupeve të krimit të organizuar. Do të bashkëpunojmë me vendet e tjera për të hetuar shmangiet ndërkufitare, duke shfrytëzuar edhe mundësitë përmes iniciativave për bashkëpunim regjional. Do të bashkëpunojmë edhe me administratat doganore të vendeve të tjera partnere tregtare, për të luftuar krimin që mund të ketë origjinën në këto vende dhe që prek vendin tonë, ose anasjelltas.

Ngritja e nivelit të komunikimit dhe bashkëpunimit me komunitetin e biznesit të Kosovës është e një rëndësie të veçante për të përmirësuar përmbushjen vullnetare të detyrimeve dhe të lehtësojë aktivitetet ekonomike të biznesit. Do të organizojmë takime individuale por edhe grupe, përfshirë ato përmes Odës Ekonomike, apo organizatave të tjera që përfaqësojnë biznesin. Njëkohësisht, do të punojmë me ta rreth përgatitjes së udhëzuesve, që do të lehtësojnë implementimin sa më të lehtë të ndryshimeve ligjore, por edhe procedurave doganore, të cilat do të vazhdojmë që t'i modernizojmë edhe me tutje

Do të punojmë ngushtë me agjentët doganorë që përfaqësojnë biznesin në procedurë, me qëllim që edhe atyre t'iu sqarohen përfitimet nga shkurtimi i procedurave doganore. Bashkëpunimi më i ngushtë me agjentët doganorë, qoftë përmes shoqatës së tyre, qoftë individualisht, do të na ndihmojë në përmirësimin e mëtutjeshëm të procedurave aktuale doganore, me çka do të bëhet i mundshëm një shfrytëzim më i mirë i resurseve njerëzore dhe materiale që Dogana i ka në posedim.

**Objektivat Strategjike:**

- Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit aktual të mbledhjes së të hyrave kufitare (Taksës doganore, Akcizës dhe TVSH),
- Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit aktual të mbledhjes të akcizës së brendshme,
- Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit aktual të mbledhjes së akcizës në Lojërat e fatit,
- Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së IT për të lehtësuar qasjen e bizneseve në shërbimet e Doganës,
- Ofrimi i lehtësirave tregtare dhe përmirësimi i komunikimit me bizneset,
- Shtimi i efikasitetit në luftën kundër kontrabandës dhe evazionit fiskal,
- Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe me gjerë në shkëmbimin e të dhënave doganore

**Masat e nevojshme :**

- Funkcionalizimi i plotë i sistemit ASYCUDA në aplikimin e duhur të metodave të vlerësimit, klasifikimit dhe përshkrimit të mallrave.
- Shfrytëzimi maksimal i sistemit ASYCUDA dhe Business Intelligence për nevoja të mbikëqyrjes së procedurave dhe profilizimit të rrezikut.
- Zhvillimi i modulit të ri për kontrollimin e lëvizjes së mallrave me akcizë brenda vendit
- Klasifikimi i duhur i mallrave në bazë të Nomenklaturës së klasifikimit të mallrave, duke përfshirë analizat laboratorike
- Funkcionalizimi i plotë i Laboratorit Qendror të Doganave
- Aplikimi i duhur i metodave të vlerësimit të mallrave
- Aplikimi i duhur i rregullave të origjinës;
- Zbatimi i plotë i tarifës së integruar -TARIK dhe masave tregtare
- Mbikëqyrja dhe kontrolli i lirimeve doganore dhe zbatimit të masave tregtare
- Krijimi i një sistemi efikas të inkasimit të akcizës së brendshme, përmes deklarimeve online dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme.
- Zbatimi i plotë i analizës së riskut dhe fokusimi të dërgesat me risk të lartë.

**Qëllimi strategjik 2:**

***Mbrojtja e qytetarëve të Kosovës nga importi i mallrave të ndaluara , dhe lufta efikase kundër krimit të organizuar dhe kontrabandës.***

Roli i Doganave është duke u përforcuar edhe në fushën e mbrojtjes së shoqërisë përmes parandalimit të futjes së substancave të dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin, parandalimit të tregtisë me mallra të ndaluara dhe një lufte më të gjerë kundër krimit të organizuar. Me zbatimin e kontrolleve sistematike në kufi dhe brendi të Kosovës Dogana do të parandalojë futjen e mallrave që mund të rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e banorëve të Kosovës dhe të regjionit.

Mbledhja , trajtimi dhe përdorimin i duhur i informacionit janë elementet kyçe për një luftë të suksesshme kundër krimit ndërkufitar ,kontrabandës dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme që kërcënojnë tregtinë ndërkombëtare dhe shoqërinë kosovare në përgjithësi. Për qëllimet e luftës kundër keqpërdorimit të sistemit doganor të Kosovës , Dogana synon të vazhdojë edhe më tutje me zhvillimin e sistemit informativ të analizës së rrezikut dhe selektivitetit, i cili do të mundësojë rritjen e efektivitetit në zbulimin veprave penale.

Vlerësimi i rrezikut dhe profilizimi i dërgesave, veturave apo personave do të zhvillohen me tutje, duke shfrytëzuar kapacitetet e sistemit Asycuda dhe shkëmbimin e të dhënave në nivelin vendor dhe ndërkombëtar. Synimi i jonë duhet të jetë që në tri vitet e ardhshme, kontrollet fizike të zvogëlohen në mënyre graduale , pa i rrezikuar te hyrat, sigurinë dhe shëndetin e popullatës.

Zhvillimi i koncepteve moderne doganore “operativa e udhëhequr nga inteligjenca”, do ndihmojë stafin operativ në fokusimin e dërgesave me risk të lartë dhe në hetimin e kontrabandës dhe krimit të organizuar. Administrata Doganore do të vazhdojë me përpjekje intensive për të përmirësuar kontrollet pas zhdoganimit.

Dogana e Kosovës , po ashtu do të azhurnojë profilet doganore dhe do të rishikojë të gjitha teknikat lokale të profilizimit të rreziqeve. Veç kësaj, Administrata Doganore e Kosovës do të iniciojë përmirësime të mëtejme në Kontrollet Kufitare nën zhvillimin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK).

Avancimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit brenda dhe jashtë vendit, do të ngritët edhe më tej me qëllim të

zbulimit, konfiskimit dhe reduktimit të mallrave ilegale dhe të ndaluara në territorin e Kosovës.

Bashkëpunimi dhe koordinimi me prokurorit publike duhet te avancohet me qëllim të hetimeve profesionale nën udhëheqjen e prokurorit publik të veprave penale doganore. Do të punohet në drejtim të arritjes efektive të menaxhimit të integruar të kufirit dhe qasjes në sistemet e ndërtuara nga agjencitë e tjera, qëllim të zhvillimit të konceptit të përbashkët në menaxhimin e integruar të kufirit.

Në tre vitet e ardhshme, Dogana e Kosovës do te rrisë kapacitetet në hetimet financiare kundër narkotikëve, përmes themelimit të njësisë së veçantë për hetime financiare dhe njësi të inteligjencës kundër narkotikëve. Ne do të përdorim një qasje të bazuar në inteligjence dhe profilizim të rrezikut për hetimet financiare dhe pastrimin e pareve, në koordinim dhe bashkëpunim me qendrën e inteligjencës financiare përmes zyrtarit ndërlidhës, si dhe me agjencitë tjera zbatimit të ligjit dhe me institucionet financiare që operojnë në Kosovë.

Prioritet i rëndësishëm do të jetë edhe fusha e mbrojtjes së pronësisë intelektuale. Ne do të avancojmë partneritetin tonë me institucionet qeveritare, industrinë private për të parandaluar kontrabandën e mallrave të falsifikuara, veçanërisht ato që mund të dëmtojnë shëndetin e popullatës, sigurinë publike dhe të hyrat.

Mbrojtja e shtuar e të drejtave të pronësisë intelektuale do të arrihet përmes bashkëpunimit me mbajtësit e këtyre të drejtave dhe përmirësimin e njëkohshëm të efikasitetit të Doganës në zbulimin e mallrave të falsifikuara.

Në këtë plan do të adresohen po ashtu të gjitha detyrat që dalin nga strategjitë nacionale dhe planet e veprimit, e që ndërlidhen me zbatimin e tyre nga Dogana e Kosovës. Dogana do të marre pjesë aktive në grupet punuese për rishikimin periodik të strategjive nacionale dhe planeve të veprimit.

Dogana e Kosovës do të vazhdoi edhe më tutje arritjen dhe zbatimin e marrëveshjeve me administratat tjera doganore .Gjithashtu do të jemi pjesëmarrës aktiv në iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare të hetimeve të përbashkëta dhe shkëmbimin e të dhënave tregtare përmes sistemeve të ndërtuara.

Duke kryer këto aktivitete , dogana do të kontribuojë ndjeshëm në shkatërrimin e organizatat vendore dhe ndërkombëtare të krimit të organizuar dhe terrorizmit.

**Objektivat strategjike:**

- Rritja e masave për sigurinë dhe mbrojtjen e territorit doganor
- Përmirësimi i aftësive operative të Doganës në zbulimin e formave të ndryshme të tregtisë së paligjshme dhe importit të mallrave të ndaluara si dhe mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale (IPR).
- Rritja e masave parandaluese, duke përfshirë edhe rritjen e kapaciteteve të kontrollit post importues;
- Zhvillimi i politikave gjithëpërfshirëse të zbatimit të ligjit
- Forcimi i bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me autoritetet tjera të zbatimit të ligjit ,për të rritur efektivitetin në zbulimin e rasteve, parandalimin e konfliktit të kompetencave ,dhe përmirësimin e besimit të ndërsjellë ;
- Zbatimi i plotë i Programit Qeveritar dhe Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë

**Masat e nevojshme:**

- Forcimi dhe modernizimin i teknikave të kontrolleve doganore me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të evazionit fiskal, kontrabandës, krimit ndërkufitar dhe terrorizmit;
- Modernizimi i vazhdueshëm i pajisjeve dhe sistemeve të trajnimit;
- Ngritja e motivimit të stafit operativ për zbulimin e kontrabandës me mallra
- Të mundësohen kontakte të drejtpërdrejtë me autoritetet e zbatimit të ligjit për qëllime të shkëmbimit të informacionit të inteligjencës dhe të kryejnë operacione të koordinuara së bashku;
- Angazhimi në drejtim të krijimit të ekipeve të përbashkëta të hetimit, për raste të veçanta me Policinë e Kosovës dhe Administratën tatimore (sipas " Programit Qeveritar dhe Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë ")
- Krijimi i kushteve teknike që do të mundësojnë ndërveprimin dhe ndërlidhjen me IT sistemet e autoriteteve të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare;
- Përmirësimi i sistemeve aktuale dhe zhvillimi i sistemeve të reja të shkëmbimit të dhënave elektronike me institucionet tjera kombëtare dhe ndërkombëtare

**Qëllimi strategjik 3:**

***Modernizimi i Doganës së Kosovës sipas standardeve të Udhërrëfyesit doganor të BE (EU Blueprint)***

Administrata Doganore e Kosovës mbështet punën e vet në kryerjen e detyrave doganore nga zyrtarët doganor të aftësuar profesionalisht. Në lidhje me këtë Dogana e Kosovës do të zhvilloj një strategji për menaxhimin e burimeve njerëzore të cilat do të përcaktojnë funksionin, rolin dhe përgjegjësinë brenda strukturës së shërbimit Doganor. Për shkak se çdo ditë e më shumë tregtia ndërkombëtare bëhet me komplekse, Administrata Doganore duhet të zhvilloj programe përtëritëse për trajnimin e Zyrtarëve Doganor, në mënyrë që ata të jenë plotësisht të informuar mbi rregulloret Doganore, procedurat dhe teknikat e operimit të bizneseve të sektorit privat. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajnimeve profesionale nga fushat vijuese: zbulimin e kontrabandës (sidomos e narkotikëve, armëve, mallrave me përdorim të dyfishtë...), njohuria e gjuhëve të huaja, dhe fushat tjera në pajtim me Strategjinë për Trajnime të Administratës Doganore.

Në mënyrë që të përmirësohet motivimi dhe përkushtimi në punë i zyrtarëve të vet, Administrata Doganore e Kosovës do të vazhdoj me funksionimin e vet transparent të sistemit të vlerësimit duke promovuar sistemin e shpërblimeve bazuar në merita dhe angazhime, e po ashtu edhe të monitoroj efektin e punës në mënyrë neutrale. Raporti vlerësues i Komisionit evropian mbi progresin e arritur në fushat kryesore të udhërrëfyesit doganor (EU Blueprint), e që janë të bazuara në praktikat më të mira të BE, është një dokument shumë i mire që ka identifikuar mungesat në kapacitetet operacionale, si dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim. Zbatimi i rekomandimeve të këtij raporti do të ketë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e objektivave zhvillimore të Doganës së Kosovës në procesin e ecjes drejt integritimit në BE dhe identifikimin e kërkesave për asistencës teknike në të ardhmen.

Arritja e standardeve të nevojshme për integrim në Bashkimin Evropian dhe institucionet e tjera ndërkombëtare janë prioritet kryesor i Qeverisë së Kosovës, pasi Institucionet e Republikës së Kosovës janë relativisht të reja. Dogana e Kosovës promovon procese përmes të cilave mundësohet plotësimi i standardeve të kërkuara për integrim në Bashkimin Evropian dhe në institucionet e tjera ndërkombëtare. Dogana e Kosovës synon të operoj në përputhje të plotë me standardet dhe përvojat më të avancuara ndërkombëtare.

Kjo do të arrihet përmes forcimit të bashkëpunimit me institucionet relevante të KE-së (DG-TAXUD, DG për Zgjerimin, OLAF), administratat doganore të vendeve anëtare

të BE, si dhe vendet kandidate potenciale për anëtarësim.

Prioriteti kryesor do të jetë zbatimi me sukses i të gjitha masave dhe veprimeve që dalin nga Marrëveshja për stabilizim –asociim (MSA) dhe Plani i Veprimit të partneritetit evropian 2013-2015 .Dogana e Kosovës do të vazhdoi edhe me tutje ngritjen e kapaciteteve institucionale në fushën e doganave përmes pjesëmarrjes aktive në aktivitetet e programit të asistencës teknike TAIEK.

Një rol të veçantë do të ketë edhe intensifikimi i pjesëmarrjes në aktivitetet e Organizatës Botërore të Doganave dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, veçanërisht atyre rajonale, me qëllim të adoptimit të praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare.

**Objektivat strategjike:**

- Plotësimi i të gjitha standardeve dhe prioriteteve të përcaktuara nga dokumentet strategjike të BE-se për qëllim të procesit të stabilizim asociimit;
- Zbatimi i instrumenteve për të arritur standardet që kërkohen për anëtarësim në Organizatën Botërore të Doganave (OBD) dhe organizatat e tjera rajonale dhe ndërkombëtare .
- Harmonizimi dhe azhurnimi i mëtutjeshëm i legjislacionit doganor në pajtim me Acquis communautaire , aktet dhe Konventat e Organizatës Botërore të Doganës (OBD) dhe Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)
- Implementimi i rekomandimeve nga raporti i vlerësimit të përmbushjes së standardeve të Udhërrëfyesit doganor të BE-së
- Krijimi i kushteve të përshtatshme të punës për stafin e Doganës së Kosovës
- Ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës Kufitare
- Zhvillimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore
- Zhvillimi i mëtejme i infrastrukturës së IT sipas Strategjisë së aprovuar të IT
- Sigurimi i mbështetjes adekuate financiare për përmirësimin e performancës së Doganës së Kosovës dhe zbatimit të lehtë të aktiviteteve të planifikuara.
- Forcimi i mëtejme i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal me qëllim të përfitimit të përvojave nga proceset integruese evropiane.
- Koordinimi i asistencës teknike dhe ndihmës së donatorëve ndërkombëtarë në fushën e doganave me qëllim të arritjes së standardeve të kërkuara.

**Masat e nevojshme:**

- Zbatimi i Planit të Veprimit për Negocimin e MSA-së dhe standardeve në procesin e Liberalizimit të Vizave
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet relevante të KE-së (Drejtorinë e Përgjithshme për Tatimet dhe Doganat, Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerimin, OLAF), administratat doganore të vendeve anëtare të BE, dhe vendet kandidate potenciale;
- Intensifikimi i pjesëmarrjes në aktivitetet e OBD dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, veçanërisht atyre rajonale.
- Adoptimi i Kodit Doganor dhe Akcizave të modernizuar të BE-se.
- Adoptimi i praktikave të Udhërrëfyesit doganor të BE-së nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore për implementimin e tyre.
- Adoptimi i dokumenteve dhe akteve të ndryshme të Organizatës Botërore të Doganës (OBD) dhe Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)
- Pjesëmarrja aktive në tryezat dhe konferencat rajonale dhe ndërkombëtare;
- Lidhja e marrëveshjeve të reja bilaterale për bashkëpunim doganor me vendet e rajonit dhe vendet e tjera partnere tregtare të Kosovës;
- Krijimi i një mekanizmi koordinues me donatorët për të maksimizuar thithjen e fondeve dhe projekteve nga programet e ndryshme të BE-së dhe donatoreve tjerë që asistojnë Kosovën në proceset integruese;
- Projekti i binjakëzimit me një vend anëtar të BE ;
- Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve doganor për adoptimin e praktikave më të mira doganore sipas standardeve të Udhërrëfyesit doganor të BE-së
- Ndërtimi i objektit të Drejtorisë së përgjithshme të Doganës,
- Implementimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve njerëzore RIMS-ERP
- Sigurimi i integritetit të bazës së të dhënave dhe sistemit Asycuda ;
- Përmirësimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së IT për të lehtësuar qasjen e bizneseve në shërbimet e Doganës;
- Zhvillimi i mekanizmit të planifikimit të buxhetit dhe aprovimit të projekteve sipas prioriteteve dhe objektivave të Planit Strategjik 2013-2015;
- Avancimi i mëtejshëm i partneritetit me Donatorët ndërkombëtar për sigurimin e përkrahjes financiare për projektet me prioritet.

**Qëllimi strategjik 4:**

***Rritja e transparencës, përmirësimi i imazhit dhe edukimi i publikut për rolin dhe misionin e Doganës***

Doganat e Kosovës, si pjesë e sistemit të administratës publike, ka për qëllim të ndërtoj, ruaj dhe të nxisë besimin e publikut të përgjithshëm në sistemin doganor, si shërbim të rëndësishëm, të orientuar në rezultate, profesional, të besueshme dhe të paanshëm, që kryen në mënyrë efektive misionin e vet në mbrojtjen e shoqërisë dhe ekonomisë prej kontrabandës, mashtrimeve, kërcënimeve për mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe pronësitë tjera.

Një ndër qëllimet kryesore të marrëdhënieve me publikun është krijimi, ruajtja dhe mbrojtja e reputacionit të organizatës, më saktësisht të fuqizohet besimi i publikut ndaj Administratës Doganore të Kosovës dhe të ndërtohet një imazh i pranueshëm. Qëllimet dhe synimet implementohen më lehtë dhe më suksesshëm me përkrahjen dhe mirëkuptimin nga opinioni i gjerë. Për shkak të rëndësisë së marrëdhënieve me publikun kërkohen përmirësime të vazhdueshme në nxënie të njohurive dhe aftësim të zyrtarëve, në mënyrë që ata jenë në një hap me trendet bashkëkohore në këtë fushë.

Dogana e Kosovës ndërmerr në vazhdimësi hapa për të ngritur nivelin e njohurisë së publikut të gjerë duke përfshirë edhe atë ndërkombëtar mbi Dogana e Kosovës dhe Republikën e Kosovës në përgjithësi, përmes aktiviteteve të ndryshme dhe publikimit të rregullt të këtyre aktiviteteve.

Udhëheqësit dhe stafi i Doganave të Kosovës marrin pjesë rregullisht në ngjarje ndërkombëtare dhe rajonale për të promovuar Republikën e Kosovës dhe Doganat e Kosovës. Bashkëpunimi i mirë me komunitetin e biznesit është më së i rëndësishëm për zbatimin efektiv të kornizës ligjore dhe të kuptuarit e nevojave të ekonomisë së Kosovës dhe tregtisë ndërkombëtare. Dogana e Kosovës është plotësisht e vetëdijshme mbi përgjegjësinë e vet ndaj palëve vendore dhe ndërkombëtare të interesit për të sjellë ekonominë e Kosovës sa më afër integritetit ndërkombëtar. Dogana e Kosovës përpiqet të ngrit nivelin e besueshmërisë së publikut ndaj aktiviteteve të veta duke promovuar kompetencë dhe performancë të lartë në kryerjen e detyrave dhe obligimeve ligjore. Do të punojmë edhe me shume në publikimin e të dhënave të ndryshme me interes, duke shfrytëzuar webfaqen tonë zyrtare, por edhe duke shtypur broshura të ndryshme informative për biznesin.

**Objektivat strategjike:**

- Krijimi i një procesi efektiv të komunikimit për përmirësimin e performancës së Doganës dhe perceptimit të saj në publik;

**Masat e nevojshme:**

- Organizimi tradicional vjetor i manifestimit "Java e Doganës" që do të përfshij një seri aktivitesh promovuese, informuese dhe sportive;
- Pjesëmarrja aktive në mediat e shkruara dhe elektronike përmes fushatave informuese për të promovuar aktivitetet dhe të arriturat e Doganës.
- Organizimi i ngjarjeve(eventeve) që ndërlidhen me ndryshimet legjislative ,shërbimet që ofron Dogana ndaj tatimpaguesve si dhe zbatimit të ligjit.

**Qëllimi strategjik 5:**

***Përmirësimi i etikës doganore dhe parandalimi i korrupsionit dhe çdo lloj konflikti të interesit;***

Përforcimi i integritetit dhe luftimi kundër korrupsionit janë caktuar si qëllime primare. Administrata Doganore veç kësaj do të përmirësoj masat anti-korrupsion, me synimin e implementimit të objektivave të duhura pa pengesa, mision dhe vizion ky i përcaktuar nga Plani Strategjik. Implementim i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i masave anti-korrupsion, përmes veprimeve të përbashkëta në të gjitha nivelet e menaxhimit dhe puna e shërbimit doganor ka për qëllim reduktimin e mundësive për korrupsion dhe rritjen e nivelit të lartë të integritetit.

Administrata Doganore veç kësaj duhet të përmirësojë edhe me tutje programin e zhvillimit të integritetit në pajtim me udhëzimet nga Organizata Botërore e Doganave. Përmes një plani të harmonizuar të aktiviteteve, duke pasur masa adekuate anti-korrupsion për natyrën dhe strukturën e shërbimit doganor, duhet të ketë procedura dhe standarde që promovojnë integritetin e shërbimit doganor, derisa në të njëjtën kohë kjo zvogëlon rrezikun nga korrupsioni. Administrata Doganore do të adoptoi një filozofi të progresit konsekuent në atë mënyrë që të

arrihet një rreth konstant i vetë-vlerësimit të integritetit, strategjisë së zhvillimit dhe vlerësimit të progresit.

Kodi i Etikës për Zyrtarët Doganor dhe punëtorët e Administratës përcakton çështjet e legjislacionit, paanshmërisë, standardeve profesionale dhe përgjegjësi të Zyrtarëve Doganor; pranimin e dhuratave, konfliktin e interesit etj.

Elemente kyçe për luftimin kundër korrupsionit janë mekanizmat e kontrollit për të zbuluar dhe parandaluar korrupsionin brenda Doganës dhe në lidhje me inicimin e masave disiplinore dhe masave tjera. Këto mekanizma duhet të përfshijnë fuqizimin e kontrollit periodik të vijës menaxheriale brenda metodave të punës dhe të rrisin integritetin e zyrtarëve. Në mënyrë që të kemi cilësi më të mirë të shkëmbimit të dhënave me institucionet e administratës publike që merren me luftimin e korrupsionit, Doganën e Kosovës do të respektoi legjislacionin e duhur kombëtar dhe marrëveshjet tjera zyrtare.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ngritjes së nivelit të vetëdijesimit të opinionit të gjerë mbi dëmin që shkakton korrupsioni dhe konfirmimin e qasjes së tolerancës zero ndaj korrupsionit, duke përfshirë po ashtu edhe qytetarët, OJQ-të, mediat dhe sektorin privat në luftimin kundër korrupsionit. Kjo nënkupton, krijimin e raporteve të hapura, transparente me palët e interesit, përcjellja e informatave në kohë të duhur dhe të saktë në pajtim me ligjin dhe rregulloret tjera, e po ashtu edhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme ndaj atyre të cilët nuk janë të informuar mbi të drejtat dhe obligimet e tyre, duke pasur parasysh se ne jemi në shërbim të shtetit dhe qytetarëve të tij. Përveç kësaj, ne do të insistojmë që të marrim vlerësime përmes anketimit të qytetarëve dhe sektorit privat mbi perceptimin e tyre për punën e shërbimit doganor, me qëllimin e përmirësimit aktiv të fushave të mundshme të rrezikut, dhe regjistrimin e të gjitha llojeve të parregullsive në punën e shërbimit doganor duke caktuar qarte mekanizmat për regjistrim.

Qytetarët e Kosovës presin nga zyrtarët doganorë që t'i kryejnë detyrat e tyre me integritet, në një mënyrë të paanshme dhe të drejtë. Dogana e Kosovës si një agjenci e zbatimit të ligjit nuk do të lejojë që interesat private të zyrtarëve doganor të komprometojnë vendimmarrjen zyrtare dhe menaxhimin e financave publike. Kur konfliktet e interesit nuk menaxhohen siç duhet, ka mundësi të dobësojnë besimin e qytetarëve tek institucionet publike. Edhe pse konflikti i interesit nuk mund të konsiderohet në mënyrë të drejtpërdrejtë si korrupsion, ekziston një shqetësim në rritje që konfliktet midis interesave private dhe detyrave publike të zyrtarëve doganor, në qoftë se nuk menaxhohen siç duhet, mund të çojnë në korrupsion.

Objektivi kryesor në parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës zyrtare nga ana e zyrtarëve doganor , do të jete përmirësimi i mekanizmave dhe mjeteve për parandalimin ,identifikimin dhe shmangien e rasteve të konfliktit te interesit që shfaqen si dhe duke zbatuar standardet e duhura të integritetit.

Ky objektivi në përgjithësi do të arrihet përmes proceseve efektive për identifikimin e riskut, parandalimin e rasteve eventuale si dhe trajnimin e stafit për konflikt të interesit.

**Objektivat strategjike:**

- Zhvillimi dhe avancimi i mekanizmave për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e rasteve të, korrupsionit, mashtrimit , konfliktit të interesit dhe shpëlarjes së parasë.
- Identifikimi i korrupsionit të dyshimtë, hetimi dhe drejtimi i shkelësve drejtë ndjekjes penale dhe zvogëlimi i shkaktarëve dhe rreziqeve nga korrupsioni në administratë.
- Rishikimi i jashtëm i proceseve të brendshme për identifikimin, fillimin dhe procedimin e rasteve te aktiviteteve korruptuese;

**Masat e nevojshme:**

- Rritja e integritetit dhe përmirësimi i standardeve të punës të punonjësve të doganës nëpërmjet zbatimit me rigorozitet të akteve normative të hartuara në mënyrë specifike për luftën kundër korrupsionit.
- Implementimi i programit RIMS në Sektorin e Personelit dhe identifikimi i mundshëm i konfliktit potencial të interesit përmes vetë deklarimit të zyrtarëve doganorë;
- Ndërmarrja e masave të nevojshme për zbatimin Planit Nacional Kundër Korrupsion në bashkërendim me Agjencinë Kundër Korrupsion;
- Implementimi i planit të përbashkët me Policinë kufitare për zbatimin e Kodit të Mirësjelljes në Pikat Kufitare Doganore;
- Inspektimi i të gjitha rasteve të iniciuara dhe shtimi i kontroleve në terren përmes procesit të inspektimit;
- Eliminimi i çdo lloji të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të zyrtarit doganor
- Trajnimi i administratës doganore në lidhje me parimet e transparencës, mirëqeverisjes dhe kundër korrupsionit.

## Monitorimi dhe vlerësimi i performancës

Implementimi i këtij plani strategjik do të bëhet përmes ndërmarrjes së masave të parapara dhe kryerjes së aktiviteteve të cilat do të detajohen në Planin e veprimit 2013-2015, i cili do të ketë edhe kornizën kohore për kryerjen e aktiviteteve dhe planifikimin buxhetor.

Matja e performancës do të bëhet përmes rishikimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të indikatorëve matës për rezultatet e aktiviteteve të parapara.

Ne do ta matim suksesin në mbledhjen e të hyrave, duke krahasuar të hyrat që do të mblidhen në raport me periudhat e njëjta gjatë viteve të kaluara si dhe zhvillimet makroekonomike në vend. Po ashtu përmes ndërtimit të një sistemi të matjes së performancës përfshirë kontrollet pas importit ,zbulimin e mallrave të kontrabanduara dhe zgjidhjes së rasteve penale do të jemi në gjendje të vlerësojmë nivelin e evazionit fiskal . Kjo do të na mundësojë për të zhvilluar një pamje të qartë të trendeve afatgjata të të hyrave, me qëllim që të jemi në gjendje të vendosim resurset tona adekuate, aty ku janë identifikuar rreziqet me të mëdha.

Përveç reduktimit të numrit të ankesave nga palët , që do të shërbejë si indikator se sa kemi arritur të përmirësojmë ambientin biznesor, në vazhdimësi do të matim kohën e nevojshme për përfundimin e procedurave doganore , me çka do të shohim se a kemi arritur përmirësim të mjaftueshëm.

Progresi i arritur në fushën e arritjes së standardeve për integrim në BE do të matet përmes raporteve të vlerësimit të Komisionit Evropian në fushën e Doganave dhe atë të zbatimit të ligjit.

Përmirësimi i imazhit publik të Doganave dhe zvogëlimi të korrupsionit do të matet përmes raporteve publike mbi vlerësimin e nivelit të korrupsionit në Kosovë dhe kënaqshmerisë së publikut me punën e Doganave.





